



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS**

Zyra Kuvendit të Komunës

Nr. 353-2329 dt. 31.01.2013

7.02.2013

Në vështrim të nenit 12 pika d, dhe nenit 40 pika e, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 31.01.2013 miratoi këtë:

V E N D I M

I. FORMOHET Komisioni Profesional për Llogaritjen e punëve të kryera në Ndërtimin e Kompleksit Drenasi i Ri në Paklek të Ri sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit, Nr. _____ të datës 2000, në këtë përberje:

1. Hakif Hasi - Kryetar të Komisionit,
2. Ajet Demiri - përfaqësues i investitorit
3. Ukë Krasniqi - përfaqësues i investitorit,
4. Afrim Prokshi - përfaqësues i investitorit,
5. Shyqyri Bublaku - përfaqësues i investitorit
6. Idriz Hysenaj - përfaqësues i Kuvendit,
7. Liman Krasniqi - përfaqësues i Kuvendit

Prezent do të jenë:

1. Përfaqësuesit e Organit mbikqyres për Drenasin e ri
2. Përfaqësuesi i firmes Kontraktuese - "Kalsin Ks"

II. Detyrat e Komisionit:

- Të bëjë llogaritjen e të gjitha punëve të kryera të gjerëtanishme sipas Kontratës të Kuvendit të Komunës së Drenasit, nr. 360-282/2 të datës 25.06.2001.
- Të shqyrtoj të gjitha kontestet eventuale nga pozicionet në drejtim me obligimet e detyrave të kontraktuara,
- Të kryej prerjen financiare të punëve të kryera të gjerëtanishme duke llogaritur të gjitha pozicionet kontestuese ose të tepërta në ndërtimin e banesave kolektive sipas Kontratës mbi ndërtim duke konstatuar së punëkryesi a po i kryen punët sipas dinamikës,
- Komisioni të jap rekomandim nga analiza e hartuar për mundësin se a është në gjendje punëkryesi për t'i vazhduar punët e kontraktuara të pakryera dhe të jep rekomandimin e prerë për ndërprerjen eventuale të punëve.

-Të hartoj pasqyrzën e punimeve të terësishme në objekte dhe të jap zgjidhje për funksionimin normal të objekteve me ndryshime dhe plotësime.


III.Përfaqësuesit e punëkryesit duhet të kenë autorizimin për përfaqësim ndërsa Kryetari i Komisionit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës të organizoj punën e Komisionit.

IV.Për punën e kryer Komisioni do të kompenzohet me Aktvendim të veqant.

V.Afati për kryrjen e detyrave nga ky Vendim është _____2013.

VI.Me këtë Vendim do të njoftohen anëtarët e Komisionit, dhe një mbetet për evidencë.

VII.. Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

/Naim Bazaj/




06.02.2013
12-400-2223



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit të Komunës
Drenas, me 06.02. 2013**

Në bazë të nenit 12.paragrafi 2 nën (d) dhe nenit 40 paragrafi 2 nën (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Neni 30. të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë me datën 31.01.2013 aprovoi këtë;

**VENDIM
PËR TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE DHE HARMONIZIMIN E
PAGAVE – MËDITJEVE NË PROGRAME-NËNPROGRAME BUXHETORE**

Neni 1.

Me këtë vendim, aprovohet transferi i mjeteve financiare nga një program në programin tjetër. Transferi i mjeteve bëhet nga mjetet e kategorisë ekonomike të shpenzimeve për paga dhe mëditje nga Buxheti i vitit 2012.

Neni 2.

Transferi i mjeteve bëhet nga këto programe sipas shumave:

- Zyra e Kryetarit në shumë prej:	581.00€
- Drejtorati për Administratë dhe Personel në shumë prej:	2,593.00€
-Drejtorati për Inspektion në shumë prej:	426.00€
-Zyra e Kuvendit në shumë prej:	968.00€
-Drejtorati për Buxhet dhe Financa në shumë prej:	287.00€
-Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër në shumë prej:	665.00€
-Drejt. për Shëndetësi dhe Mirëqenje Soci.në shumë prej:	4,365.00€
Gjithsej:	9,885.00€

Neni 3.

Gjithsej shuma e mjeteve për transfer e të përmendur në nenin 2. të këtij vendimi transferohet të këto programe sipas këtyre shumave:

-Drejt.për Shërb. dhe Emërgjencë në shumë prej:	3,331.00€
-Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim në shumë prej:	1,641.00€
-Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim në shumë prej:	2,390.00€
-Drejtorati i Arsimit-Arsimi Fillor në shumë prej:	2,523.00€
Gjithsej:	9,885.00€

Neni 4.

Me këtë vendim, aprovohet edhe harmonizimi i pagave-mëditjeve në Sektorin e Arsimit nga nënprogrami në nënprogramin tjetër dhe si vion;

Mjetët zbritën nga:

-Administrata e Arsimit në shumë prej:	2,576.00€ dhe
-Arsimi i Mësem në shumë prej:	2,446.00€
Gjithsej Zbritje:	5,022.00€

Mjetët rritje në:

-Asimin Parashkollor(Qerdhëtl në shumë prej:	363.00€ dhe
-Arsimin Fillor në shumë prej:	4,659.00€
Gjithsej Zbritje:	5,022.00€

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, dhe për aplikimin e tij do të kujdesen; Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Buxhet-Financa.





Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Në mbështetje të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Statutit të Komunës dhe rregullores për punën e kuvendit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2013 planifikon këtë:

Orar të seancave të Komitetit për politikë dhe financa dhe seancave të K.K-al për vitin 2013

<u>Janar</u> Seanca e K.P.F-a me 23.01.2013 ora 11.00 Seanca e Rregullt e K.K-al me 31.01.2013-ora 10.00	<u>Shkurt</u> Seanca e K.P.F-a, me 14.02.2013 ora 11.00 Seanca e Rregullt e K.K-al me 26.02.2013 ora 13.00	<u>Mars</u> Seanca e K.P.F-a me dt.18.03.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K.-al me dt.29.03.2013-ora 13.00
<u>Prill</u> Seanca e K.P.F-a me dt.19.04.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K-al me 30.04.2013 ne ora 13.00	<u>Maj</u> Seanca e K.P.F-a me 20.05.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K-al me 31.05.2013 ora 13.00	<u>QERSHOR</u> Seanca K.P.F-a, me 12.06.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K-al me 21.06.2013 ora 13.00
<u>Korrik</u> xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx	<u>Gusht</u> Seanca e K.P.F-a, me 20.08.2013 ora 11.00 Seanca e Rregullt e K.K-al me 30.08.2013 ora 13.00	<u>Shtator</u> Seanca e K.P.F-a me dt.12.09.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K.-al me dt.20.09.2013-ora 13.00
<u>Tetor</u> Seanca e K.P.F-a me dt.18.10.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K-al me 31.10.2013 ne ora 13.00	<u>Nëntor</u> Seanca e K.P.F-a me 18.11.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K-al me 26.11.2013 ora 13.00	<u>Dhjetor</u> Seanca K.P.F-a, me 11.12.2013 ora 11.00 Seanca e rregullt e K.K-al me 20.12.2013 ora 13.00



Kryesusi i Kuvendit
Naim Bazaj